



## Dhjetë vite rrugëtim i suksesshëm i Odës së Stomatologëve të Kosovës

Një dekadë më parë, me vizionin dhe përkushtimin e përbashkët të komunitetit tonë dhe autoriteteve shtetërore u themelua Oda e Stomatologëve të Kosovës, me misionin “*për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e përbashkëta të anëtarëve të saj dhe të vendos standarde të larta të kodit etik për çdo stomatolog që ushtron profesionin në Republikën e Kosovës*”.

Gjatë kësaj dekade, një nga përpjekjet kryesore të OSK-së kanë qenë aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional të anëtarëve të Odës përmes kongreseve, konferencave, seminareve, punëtorive, kurseve dhe programeve të specializuara profesionale, duke i mundësuar anëtarësisë përmirësimin e njohurive dhe shkathtësive të tyre profesionale, e me këtë, edhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve stomatologjike për qytetarët e Kosovës.

OSK-ja ka pasur një angazhim të veçantë në anëtarësimin e saj në mekanizmat ndërkombëtar dhe në bashkëpunimin me odat rajonale e më gjerë. Tashmë OSK-ja është anëtare e rregullt e Federatës Botërore të Stomatologjisë (FDI) dhe Organizatës Regionale Evropiane të Federatës Ndërkombëtare të Stomatologjisë, si dhe janë nënshkruar shumë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore.

Vitin e kaluar është realizuar ëndrra e kamotshme e të gjithë neve: themelimi i Revistës së Stomatologëve të Kosovës – RSK. Me këtë është krijuar hapësira e duhur për promovimin e të arriturave profesionale dhe akademike në fushën e stomatologjisë dhe numrat e parë të RSK-së dëshmojnë se kemi arritur që të krijojmë një revistë të pëlqyeshme për lexuesin e saj.

OSK-ja ka qenë një zë i rëndësishëm për gjendjen në sektorin e stomatologjisë në vendin tonë. Kemi hartuar *Strategjinë e zhvillimit të stomatologjisë në Republikën e Kosovës*, në të cilin dokument është hartuar edhe vizioni i OSK-së për reformimin e sektorit të stomatologjisë, të bazuar në modelet e përvojat më të mira rajonale dhe më gjerë.

Në këtë përvjetor shprehim mirënjohjen tonë më të thellë për të gjithë ata që kanë kontribuar në themelimin e OSK-së dhe sukseset e saj gjatë këtyre dhjetë viteve. Me respekt dhe mirënjohje të thellë, falënderojmë *Luxembourg Development Cooperation Agency - LuxDev*, për mbështetjen e vazhdueshme që na ka ofruar në rrugëtimin tonë drejt suksesit. Nëpërmjet ekipit të tij të përkushtuar dhe ekspertizës së tyre të lartë, LuxDev po realizon dy projekte madhore: (1) të ndërtesës së përbashkët të odave të profesionistëve shëndetësorë (OPSH) dhe (2) të platformës digjitale të shërbimeve administrative për profesionistët shëndetësorë.

Shfrytëzoj rastin për të falënderuar të gjithë anëtarët e OSK-së për përkushtimin dhe pasionin e tyre për punë. Kontributi i tyre nuk ka qenë thjesht një punë, por një angazhim i vërtetë, dhe unë jam krenar që jam pjesë e pandashme e të arriturave të OSK-së gjatë kësaj dekade.

Drejt sukseseve të mëtejshme!

Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës  
Prof. Dr. Blerim Kamberi